



VLERËSIMI I KAPITALIT NATYROR

BASHKIA ROSKOVEC



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri



VLERËSIMI I KAPITALIT NATYROR

BASHKIA ROSKOVEC

Tiranë, qershor 2022

Studimi u mbështet nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Prezenca në Shqipëri.
www.osce.org/albania

Udhëhoqi grupin e punës

Dr. Elton Qëndro,
Departamenti për Qeverisjen në Çështjet Ekonomike dhe Mjedisore
Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Përgatitur nga:

M.Sc. Agron Haxhimali, ekspert për qeverisjen vendore
Dr. Arbi Shehu, ekspert i burimeve natyrore
Dr. Kledian Kodra, ekspert për ekonominë dhe financat

Kontribuan

Dr. Ledjon Shahini, Ministria e Brendshme
Dr. Enea Hoti, Agjencia për Mbështetjen e Vetqeverisjes Vendore
Znj. Adelina Farrici, Shoqata për Autonominë Vendore
Znj. Shila Bandilli, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Grupi i Punës i Bashkisë Roskovec nën drejtimin e

Znj. Majlinda Bufi, Kryetare e Bashkisë
Selman Cepele, Drejtor Ekonomik
Delina Hoxha, Drejtor Juridik dhe i Burimeve Njerëzore
Shkelqim Plaka, Drejtor i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Eneida Hoxha, Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
Mirel Prifti, Përgjegjës i tatim-taksave.

Ky dokument është porositur nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri. Pikëpamjet e shprehura në këtë metodologji nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e Figurave	6
Lista e Tabelave	6
Lista e Shkurtimeve	7
Përmbledhje Kryesore	9
1. HYRJE	11
1.1 Qëllimi dhe objekti i raportit	11
1.2 Metodologjia	12
2. Profili i i Bashkisë Roskovec.....	15
2.1 Ndarja territoriale e bashkisë	15
2.2 Kapitali Natyror i bashkisë Roskovec.....	16
2.3 Infrastruktura e ujitjes – rezervuarët	16
2.4 Monumenteve kulturore dhe natyrore	17
2.5 Kapitali Njerëzor në bashkinë Roskovec.....	18
2.6 Kapitali Social në bashkinë Roskovec	19
2.7 Kapitali i Prodhuar në bashkinë Roskovec.....	19
2.8 Kapitali Financiar i bashkisë Roskovec	20
2.9 Sistemet territoriale	21
3. IDENTIFIKIMI I BURIMEVE NATYRORE.....	22
3.1 Burimet minerare	22
3.2 Burimet Ujore.....	24
3.3 Parqet.....	24
3.4 Pyjet	25
3.5 Bujqësia dhe Blegtoria	25
3.6 Biodiversiteti	28
4. VLERËSIMI MONETAR I BURIMEVE NATYRORE.....	32
4.1 Burimet minerare	32
4.2 Burimet Ujore.....	33
4.3 Parqet.....	34
4.4 Pyjet	34
4.5 Bujqësia dhe Blegtoria	37
4.6 Biodiversiteti	38
5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	40
5.1 Rezultatet	40
5.2 Rekomandime	42
6. LITERATURË	43
Shtojca A: foto nga Konsultimi i raportit kapitali natyror.....	44

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Qasja skematike dhe metodike për kryerjen e kapitalit natyror	12
Figura 2. Vlerësimi i kapitalit natyror në bashki	13
Figura 3 Pamje nga kodrat e zonës Roskovecit dhe Kisha e Shën kollit	15
Figura 4 Kasha e Kurjanit shek. VIII	17

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Përbërja territoriale e bashkisë Roskovec.....	15
Tabela 2. Shpenzimet e bashkisë Roskovec sipas natyrës	20
Tabela 3. Shpërndarja Urbane	21
Tabela 4. Sasia e Rezervave Gjeologjike ne Patos Marinzë.....	22
Tabela 5. Rezervat e llogaritura nga Bankers Petroleum	23
Tabela 6. Të dhëna nga shfrytëzimi hidrokarbur në Patos Marinzë.....	23
Tabela 7. Sipërfaqet e Pyjeve, Bashkia Roskovec	25
Tabela 8. Sipërfaqet e Tokës Bujqësore sipas Njësive Administrative, Bashkia Roskovec	25
Tabela 9. Shumëllojshmëria e prodhimeve bujqësore	26
Tabela 10. Shumëllojshmëria e Pemëve Frutore	27
Tabela 11. Shumëllojshmëria e Agrumeve.....	27
Tabela 12. Llojet e të mbjellave	28
Tabela 13. Shumëllojshmëria blegtorale	28
Tabela 14 Shumëllojshmëria e peshqve dhe produkteve ujore.....	29
Tabela 15 Shumëllojshmëria e Florës dhe Faunës	29
Tabela 16. Vlera e prodhimit dhe rezervave të naftës.....	33
Tabela 17. Vlera e fluksit monetar vjetor dhe aktivitet monetar nga energjia fotovoltaike	33
Tabela 18. Vlera e fluksit monetar vjetor nga burimet ujore	34
Tabela 19. Vlera e burimeve pyjore në rast përdorimi për sekuestrim karboni	35
Tabela 20. Të ardhura vjetore të mundshme nga burimet pyjore në rast përdorimi për dhënien me qira.....	36
Tabela 21. Vlera e aktivitet pyjor në rast përdorimi për dhënien me qira.....	37
Tabela 22. Vlera e fondit të tokave në rast përdorimi për dhënien me qira	37
Tabela 23. Vlera e prodhimeve bujqësore.....	38
Tabela 24. Vlera e fluksit vjetor të prodhimeve blegtorale.....	38
Tabela 25. Vlera e fluksit vjetor të kapjes së peshkut	39
Tabela 26 Vlera e pasurisë natyrore të Bashkisë Roskovec	41

LISTA E SHKURTIMEVE

AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
AMBU	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
AKT	Agjencia Kombëtare e Turizmit
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
KN	Kapitali Natyror
SHGJSH	Shërbimi Gjeologjik Shqipëtar
SKME	Sistemi i Kontabilitetit Mjedisor-Ekonomik




PËRMBLEDHJE KRYESORE

Bashkia Roskovec ka në dispozicion një larmishmëri të llojeve të kapitalit natyror (KN) duke përfshirë burimet minerare, burimet ujore, pyjet dhe kullotat, tokat bujqësore, burime energjitike të rinovueshme, parqe natyrore me potencial turistik dhe rekreacioni si edhe me një biodiversitet të pasur mes florës dhe faunës. Ndër burimet kryesore spikat energjia fosile nëpërmjet vendburimit të naftës në Patos-Marinzë. Hartuesit e këtij punimi dolën në përfundime rreth inventarit sasior dhe monetar të burimeve natyrore të lartëpërmendura duke marrë për bazë tabelat e burimeve dhe përdorimit të tyre duke u përpjekur të replikojnë praktikën më të mirë të sygjëruar nga kuadri qendror i Sistemeve të Kontabilitetit Mjedisor-Ekonomik (SKME) në nivelin e bashkisë Roskovec.

Në bazë të analizës së realizuar, fluksi vjetor monetar nga KN në bashkinë Roskovec është rreth 56 miliardë lekë (468 mln Euro), ndërsa aktivi monetar llogaritet rreth 259 miliardë lekë (2.2 miliardë Euro). Duhet të sjellim në vëmendje që 52% e vlerës monetare të fluksit vjetor dhe 39% të aktivitetit, rezultojnë nga vlerësimi i vendburimit të Patos-Marinzës, i cili në fakt, nuk i përket vetëm bashkisë Roskovec. Gjithashtu një pjesë të konsiderueshme të aktivitetit monetar e zë (16.6%) potenciali i bashkisë për shfrytëzimin hapësirave për gjenerimin e energjisë së rinovueshme nëpërmjet teknologjisë së fotovoltaikeve. Gjithashtu, shifrave të mësipërme u mungon vlera e mundshme, pritshmerisht e lartë, e potencialit agroturistik dhe kulturor.

KAPITALI NATYROR ROSKOVEC



1. HYRJE

Ky raport është vlerësimi i kapitalit natyror të bashkisë Roskovec. Synimi i këtij raporti është të krijojë një vlerësim bazë të kapitalit natyror në bashki dhe të trajtoj çështjet e grumbullimit, aksesit dhe analizës së të dhënave në nivel bashkie. Nevoja për këtë raport rrjedh nga mungesa e një vlerësimi rutin për gjendjen e kapitalit natyror dhe aftësisë së tij për të mbështetur shërbimet kritike të ekosistemit në nivel vendor. Sot, teknikat moderne që ekzistojnë përgjatë një larmie të gjerë disiplinash, e bëjnë të mundur një analizë të kapitalit natyror në kushtet.

Ky raport bën të mundur lidhjen e kapitalit natyror në bashkinë Roskovec me llogaritë kombëtare dhe mundëson një kuadër për të kuantifikuar vlerën e kapitalit.

Raporti është i bazuar në një metodologji të hartuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri për “Vlerësimin e Kapitalit Natyror”¹. Duke ndjekur linjën metodike, raporti është i ndërtuar në tre kapituj kryesor: i) kapitulli i parë paraqet një profil të përgjithshëm të bashkisë Roskovec në këndvështrimin social-ekonomik, mjedisor, historik dhe kulturor; ii) në kapitullin e dytë të raportit prezantohet një hartëzim i gjithë elementëve sasior dhe cilësor të kapitalit natyror në bashkinë Roskovec; iii) në kapitullin e tretë paraqitet vlerësimi monetar i kapitalit natyror të Bashkisë Roskovec bazuar në të dhënat sasiore të paraqitura nga Grupi i Punës së bashkisë.

1.1 QËLLIMI DHE OBJEKTI I RAPORTIT

Qëllimi kryesor i këtij raporti është të trajtojë pyetjet e mëposhtme: Kush është kapitali natyror në bashkinë Roskovec dhe kush është vlera ekonomike, monetare e këtij kapitali? Për t’iu përgjigjur këtyre pyetjeve, ky raport ka si objekt:

- Të zhvillojë një inventar të detajuar sasior dhe cilësor të kapitalit natyror në bashkinë Roskovec duke analizuar gjithë potencialin e mundshëm kërkimor, statistikor përgjatë një sërë sektorësh;
- Të vlerësojë vlerën monetare të këtij kapitali duke përdorur formula dhe metodologji specifike sipas legjislacionit në fuqi për elementët e kapitalit;
- Për të zbatuar këto objektiva, projekti i mbështetur nga Prezenca e OSBE-së në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe bashkinë Roskovec, ka kryer këto detyra:
- Shqyrtim të literaturës dhe punë kërkimore;
- Shqyrtim të listës së asetëve dhe kapitalit natyror të paraqitur nga Grupi i Punës i krijuar në nivel bashkie;
- Organizimin e një takimi teknik me Grupin e Punës së bashkisë Roskovec për të diskutuar mbi sfidën e mbledhjes së statistikave, mënyrën e përlogaritjes dhe burimet e informacionit;
- Hartimin e raportit të Kapitalit Natyror të bashkisë Roskovec;
- Organizimin e një takimi konsultues dhe vlerësues të raportit paraprak (më 8 korrik 2022) më pjesëmarrjen e gjithë aktorëve vendorë, Ministrisë së Brendshme, Agjencisë për Mbështetjen e Qeverisë Vendore dhe shoqërisë civile;
- Përfundimin e raportit dhe dorëzimin pranë Bashkisë Roskovec.

¹ Kodra. K, Shehu.A, Haxhimali.A, (2021). Metodologji për vlerësimin e kapitalit natyror. (OSCE) Tiranë, 2021

1.2 METODOLOGJIA

Ky raport është bazuar në metodologjinë e hartuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri sëbashku me Ministrinë e Brendshme (OSCE & MB, 2021).² Referuar kësaj metodologjie, është bërë i mundur përcaktimi i “përkufizimit” dhe kuadrit të kapitalit natyror, me punën e një sërë ekspertësh nga disiplina të ndryshme. Figura 1, më poshtë prezanton qasjen skematike të procesit të kryerjes së vlerësimit të kapitalit natyror, bazuar në metodologji.



Figura 1. Qasja skematike dhe metodike për kryerjen e kapitalit natyror.

² Kodra, K, Shehu, A, Haxhimali, A, (2021). Metodologji për vlerësimin e kapitalit natyror. (OSCE) Tiranë, 2021

Në këtë kontekst, metodologjia e ndjekur për këtë raport ka qenë si më poshtë:

KRIJIMI I GRUPIT TË PUNËS:

Me urdhër të kryetares së bashkisë u krijua grupi i punës në nivel bashkie. Grupi i punës përbehej nga specialistë të sektorëve kyç për kapitalin natyror si: mjedisi, turizmi, bujqësia, pyjet, ujërat, taksat, energjia dhe burimet, por edhe nga zyra të tjera shërbimesh vendore, brenda dhe jashtë bashkisë.

Grumbullimi i të dhënave.

Grupi i punës, filloi të grumbulloi të dhëna sipas metodologjisë me qëllim popullimin e databazës për një analizë sa më të plotë për KN. Mbledhja e të dhënave, edhe pse një sfidë, u tejkalua duke përdorur të gjitha burimet nga institucione vendore, rajonale dhe kombëtare. Përpunimi i të dhënave u përqendrua në sasinë, cilësinë dhe vendndodhjen e aseteve të KN.

Përgatitja e raportit paraprak. Raporti është përgatitur hap pas hapi sipas metodologjisë. Për çdo hap përgatitej një draft nga bashkia në konsultim dhe asistencën e ekspertëve të fushës. Më tej, draftit për çdo hap i rishikoheshin dhe verifikoheshin të dhënat nga burime të ndryshme.

Konsultimi. Raporti paraprak u konsultua fillimisht së brendshmi nga grupi i punës, i cili më pas e konsultoi atë me aktorë të tjerë dhe sidomos me siguruesit e të dhënave. Më pas raporti paraprak u konsultua në një seminar vendor me përfaqësues vendor, ekspertë teknik, përfaqësues të njësive administrative dhe fshatrave (Shih Shtojcën A).

Përfundimi dhe miratimi i raportit nga Bashkia. Raporti mbi KN, i strukturuar sipas metodologjisë, ka kaluar disa filtra në tërë prezantimin e tij. Pjesa narrative dhe ajo me të dhëna mbi llogaritë financiare, funksionet dhe vlerësimin e çdo aseti, ishte objekt i trajtimit të konsultimeve të gjëra profesionale dhe statistikore. Miratimi i parë informal i raportit ka kaluar nga grupi i punës në bashki dhe më pas raporti ka marrë edhe një miratim formal nga kryetarja e bashkisë.



Figura 2. Vlerësimi i kapitalit natyror në bashki

2. PROFILI I I BASHKISË ROSKOVEC

Roskoveci njihet si një vendbanim i hershëm i pozicionuar në kryqëzimin e tre qyteteve të lashtë Apolonia, Berat e Bylis, pranë të cilit kalonte dhe një nga degëzimet e rrugës Egnatia. Një element tjetër i cili e vërteton lashtësinë e tij janë dhe tumat e Strumës. Bashkia Roskovec përbëhet nga 32.164 banor me një dendësi prej 184 banore për km², sipas census të vitit 2011.³



Figura 3 Pamje nga kodrat e zonës Roskovecit dhe Kisha e Shën kollit

2.1 NDARJA TERRITORIALE E BASHKISË

Bashkia e Roskovecit përbëhet nga 4 njësi administrative: Roskovec; Kuman; Kurjan; Strum . Territori i bashkisë së Roskovecit shtrihet pjesërisht mbi zonën naftëmbajtëse Patos-Marinze, e cila përbën një burim natyror të rëndësishëm dhe potencial për zhvillimin ekonomik. Sektorët që ofrojnë punësim për banorët e zonës janë industria e nxjerrjes së naftës, sektori i ndërtimit, bujqësia, blegtoria dhe pemëtaria.

Tabela 1. Përbërja territoriale e bashkisë Roskovec

Qarku Fier (Bashkitë)	Nr. Bashkive	Bashkia	Njësi Administrative	Qytetet dhe Fshatrat në përbërje të tyre
Fier Patos Roskovec Lushnjë Divjakë Mallakastër	6	Roskovec	Roskovec	Qyteti Roskovec, Fshati: Jagodine
			Kuman	Fshatrat: Kuman, Marinez, Vidhishtë, Luar
			Kurjan	Fshatrat: Kurjan, Mbers, Ngjeqan, Vlosh
			Strum	Fshatrat: Strum, Arapaj, Suk 1, Suk 2, Velmish

³ http://www.instat.gov.al/media/3063/5__fier.pdf

2.2 KAPITALI NATYROR I BASHKISË ROSKOVEC

Bashkia e Roskovecit është pjesë integrale e territorit të Qarkut Fier, një nga 12 qarqet e vendit, dhe që ndodhet në pjesën jug-perëndimore të vendit në një terren kodrinor të ulët dhe fushor (pjesë e fushës së Myzeqesë). Roskoveci ndodhet në pjesën juglindore të fushës së Myzeqesë, pikërisht në kufi me kodrat e Mallakastrës. Kufizimi me bashkinë Lushnjë, në veri, me Mallakastrën në jug, me bashkinë Dimal në lindje, me bashkinë Patos në jugperëndim e bën atë një qendër urëkalimi të një zone me sipërfaqe 118.01 km². Kryeqendra e saj është qyteti i Roskovecit. Vargjet kodrinore me lartësi më të madhe (mbi 250 m) ndodhen në pjesën lindore, ato me lartësi mesatare (100-150 m) shtrihen në zonën qendrore dhe shkojnë deri në fushë, kurse zonat e ulëta ose fusha e “Myzeqesë” shtrihet në veri-perëndim, perëndim dhe jug-perëndim të territorit.

Fusha e Roskovecit, e formuar nga depozitimet e Semanit 1.5 milion vjet më parë nuk është krejt e rrafshët. Hidrografia përbëhet nga lumi Seman, disa përrrenj që e furnizojnë atë, liqeni artificial i Kurjanit dhe Këneta e Zezë e Strumit, një pjesë e rëndësishme ekologjike, pjesërisht e dëmtuar por dhe e pashfrytëzuar. Në veri-lindje të qytetit ndodhet Liqeni i Kurjanit, ndërsa në veri-perëndim ndodhet fshati Jagodinë, që është pjesë e bashkisë së Roskovecit. Kolektori i tokave të fushës së Myzeqesë dhe lumi Seman e kufizojnë bashkinë e Roskovecit nga rajonet e tjera. Aktualisht përfshihen 14 fshatra, me një popullsi prej rreth 34 000 banorësh.

Dy drejtimet kryesore të zhvillimit të marra në konsideratë nga bashkia Roskovec janë: bujqësia, e cila ndahet në fushore (perimet, frutoret, prodhime bujqësore) dhe kodrinore (kultura e ullirit). Investimet në bujqësi kanë synuar gjithnjë të rritjen e numri të mbjelljeve dhe prodhimeve vendase, të përmirësohet kapaciteti prodhues dhe të marketohen prodhimet me markë vendase. Një proces i rëndësishëm është standardizimi dhe çertifikimi i vajit të ullirit në treg. Realizimi i këtyre pikave ndikon në zhvillimin ekonomik vendas. Infrastruktura rrugore, e cila përveçse siguron lehtësimin e aksesit, zhvillimin e aktivitetit urban gjithashtu shërben si mbështetëse ndaj bujqësisë (në ujitje dhe kullim).

2.3 INFRASTRUKTURA E UJITJES – REZERVUARËT

Hidrografia në territorin e bashkisë Roskovec përbëhet nga: Këneta e zezë, Rezervuari i Kurjanit, i cili furnizohet nga Përroi i Kurjanit dhe Përroi i Cukalatit, Rezervuari i Ngjeqarit, i cili furnizohet nga mbledhja e ujërave natyrore (shirave dhe burimet ujore nëntokësore). Të gjitha këto burime ujore kanë vlerë të madhe, pasi nëpërmjet tyre realizohet vaditja e tokave, e cila bën të mundur realizimin e prodhueshmërisë bujqësore.

Hidrografia në territorin e bashkisë Roskovec përbëhet nga:

- Këneta e zezë;
- Rezervuari i Kurjanit, i cili furnizohet nga Përroi i Kurjanit dhe Përroi i Cukalatit;
- Rezervuari i Ngjeqarit, i cili furnizohet nga mbledhja e ujërave natyrore (shirave dhe burimet ujore nëntokësore);

Lumenjtë Semani është i rëndësishëm jo vetëm nga pikëpamja hidrike, por dhe nga impakti mjedisor që shkaktajnë apo pësojnë. Lumi Seman, nga i cili marrin sasi të konsiderueshme për vaditjen e tokave banorët e zonës në fshatrat Jagodinë, Suk dhe Arapaj. Aktivitetet ekonomike kryesore (me peshë më të madhe) në nivel të bashkisë janë bujqësia dhe blegtoaria (53.9%), shërbimet (14.7%) dhe industria (10.7%).

2.4 MONUMENTEVE KULTURORE DHE NATYRORE

Kisha e “Shën Kollit” ndodhet në Kurjan është një monument i shekullit të XIII, i ndërtuar në stilin bizantin. Pikturat murale të cilat zbukurojnë brendësinë e kishës, janë veprat e ikonografit Nikolla, biri i Onufrit dhe ndihmësit të tij, Joanit.



Figura 4 Kisha e Kurjanit shek. VIII

KISHA E SHËN KOLLIT (KURJAN)

Kjo kishë përfaqëson një monument të trashëgimisë kulturore në Kurjan, rrethi i Fierit, në qarkun e Fierit, Shqipëri. Ky monument është miratuar me numër “6, 15.01.1963”. Në periferi të Kurjanit, gjendet mbi një kodër të vetmuar

KISHA E SHËN NIKOLLËS

E ndërtuar me muraturë me tulla të kuqe dhe gurë të skuodruar tek qoshet, kjo faltore është ndërtuar në

shekullin e XIII, në stilin bizantin. E përbërë nga Naosi (salla) dhe narteksi (parasalla) kisha e Shën Kollit siç quhet nga vendasit, dikur mbulohej nga një qemer cilindrik tipik për kishat ortodokse.

KËNETA E ZEZË

“Kënetat e Zezë” ndodhet në Strumë dhe është monument natyror, e cila përpara bonifikimit krijonte një basen të madh ujor, që vijonte me kënetën e Roskovecit, për të vijuar më pas me ato të Marinzës, Sheqishtës dhe në fund atë të Sheqit. Kënetat u ka rezistuar kohërave dhe është origjinale me kallëma të egër nënujor, peshq, shpendë dhe ujë e zi, asnjëherë shterues. E veçantë në Shqipëri, me një burim ujor, por që nuk është gjetur asnjëherë shkak i ngjyrës së zezë. Gojëdhënat tregojnë se vite më parë banorët janë tmerruar, pasi nga thellësia e kënetës janë dëgjuar ulërime të cilat shtojnë akoma më shumë misterin e kënetës. Një bimë e rrallë, me tre gjethe mbulon gjithë sipërfaqen e pellgut burimor duke e bërë më tërheqëse dhe për vizitorët.

LIQENI I KURJANIT

Liqeni i Kurjanit është sot një nga rezervuarët më të mëdhenj dhe produktiv që i jep jetë Myzeqesë, pa të cilin nuk do të quhej “hambari i Shqipërisë”. I ndërtuar në një vend të studiuar, ky rezervuar filloi të vihet në punë në vitin 1960 dhe kishte rreth 33 milion metër kub ujë.

Liqeni ka formën e një dorë që i ka shtrirë gishtat nga veriu. Dikur përdorej për kultivimin e peshkut sidomos të krapit, amurit, ballgjërit apo karasit, por dhe mbarështimin e rosave, në një nga fermat më të mëdha në Shqipëri.

2.5 KAPITALI NJERËZOR NË BASHKINË ROSKOVEC

Gjatë dekadës së fundit, Shqipëria ka shënuar përmirësime të rëndësishme në cilësinë e arsimit. Gjithashtu, Shqipëria ka rritur numrin e viteve të pritshme të shkollimit. Një fëmijë që nis sot shkollën, pritet të kryejë 12.9 vjet shkollim deri në moshën 18 vjeç, krahasur me 11.6 vjet që ka qenë në 2020.⁴

Në një kohë, kur ekonomia rritet dhe diskutimi për të ardhmen e punës përkundrejt automatizimit dhe digjitalizimit të shumë sektorëve, është më rëndësi të kuptohet në nivel vendor mundësitë që krijohen nga teknologjia. Kush janë pozicionet që do të ndikohen, do të rrisin prodhimtarinë, do të hapin vende të reja pune dhe do të mbyllin disa të tjera në bashkinë Roskovec?

Kur analizojmë këtë sfidë të kapitalit njerëzor është me rëndësi të kuptohet, se shumë fëmijë që aktualisht janë në shkollë fillore, do të punojnë punë që për të rriturit e sotëm as nuk ekzistojnë.

Sipas studimit të Bankës Botërore (2019), shumica e punëve sot dhe shumë të tjerë në të ardhmen do të kërkojnë aftësi specifike, një kombinim të ekspertizës teknologjike, aftësisë për të zgjidhur probleme, dhe të menduari kritik dhe njëkohësisht aftësitë tjera si vendosmëria, bashkëpunimi dhe empatia.⁵

⁴ World Bank. 2019. *World Development Report 2019: The Changing Nature of Work*. Washington, DC: World Bank. doi:10.1596/978-1-4648-1328-3. License: Creative Commons Attribution CC BY 3.0 IGO

⁵ World Bank. 2019. *World Development Report 2019: The Changing Nature of Work*. Washington, DC: World Bank. doi:10.1596/978-1-4648-1328-3. License: Creative Commons Attribution CC BY 3.0 IGO

Në këtë kontekst është me rëndësi të kuptojmë trendin e punësimit dhe në bashkinë Roskovec. Forca e punës ekzistuese është përqendruar kryesisht të profesionistë të ulët dhe të mesëm më pak, në fushën e bujqësisë dhe shërbimeve të ndryshme në sektorin privat, ndërsa në sektorin e naftës burimet njerëzore janë me nivel formimi profesional kryesisht të mesëm por edhe të lartë

Sektorët ku është e përqendruar kjo forcë janë kryesisht bujqësia dhe shërbimet bujqësore, tregtare artizane dhe sektori nxjerrjes së naftës.

Sektorët si bujqësia, tregtia, industria e lehtë ushqimore nuk dallojnë për kapacitete dhe përdorim të sistemeve digjitale, edhe pse ka 2-3 subjekte që kanë në përdorim teknologji moderne.

Nevojat për punësim në të ardhmen në këta sektor është një sfidë e madhe përgjithësisht. Por mbi të gjitha, vihet re një mungesë e fuqisë punëtore në sektorin e bujqësisë edhe për krahun e lirë dhe jo profesionistë në këtë sektorë.

2.6 KAPITALI SOCIAL NË BASHKINË ROSKOVEC

Kapitali social i një shoqërie është i përcaktuar në lidhje me marrëdhënien që është e bazuar në strukturën e organizimit vullnetar, normat e reciprocitetit dhe bashkëpunimit.⁶ Në këtë kontekst, ekzistenca e organizimeve të bashkëpunimit mes shoqërisë civile, grupeve vullnetare dhe atyre komunitare është një tregues i fortë i vendimarrjes publike, të gjitha sëbashku formojnë kapitalin social të një shoqërie.

Roskoveci ka një qëndrueshmëri në organizimin e festave vendore si: Festa e serave të gjelbërta (zhvillohet në maj), Festa e Bashkisë çdo 24 korrik, Festa e njeriut të vitit, Festa e Ullirit çdo tetor)

Roskoveci ka nja komunitet të qëndrueshme dhe dinamik që prej shumë vitesh gëzon një qëndrueshmeri social. Jeta e banorëve është e integruar dhe harmonizon me nevojat dhe pritshmëritë e të gjithë grup-moshave, me njerëz që aftësohen për t'i kontribuar zhvillimit dhe inovacionit, me komunitete që ruajnë e përçojnë vlerat tek të rinjtë, e ku bashkëpunimi rrit prurjet dhe shanset e përparimit për të gjithë. Emigrimi dhe lëvizja e lirë kanë ndikuar në cilësinë e jetës së komunitet në Roskovec.

Roskoveci ka popullsi dinamike dhe ka një numër të madh punonjësish të arsimuar dhe me potencial të mirë për punë teknike, profesionale (në fushën e bujqësisë dhe përpunimit të naftës por jo vetëm), administrative dhe politikëbërëse. Administrata e qytetit është një trupë me 180 persona të arsimuar mirë në fushat e inxhinierisë, ekonomisë dhe juridiksionit, arsimit, planifikimit, etj. Roskoveci ka një numër personalitetesh të vlerësuar me tituj nga bashkia për kontributin e tyre në zhvillimin e zonës.

2.7 KAPITALI I PRODHUAR NË BASHKINË ROSKOVEC

Roskoveci është nga zonat naftëmbajtëse në Shqipëri. Fushat naftëmbajtëse e Marinëz dhe Jagodinë, ku së bashku me fshatrat kufitare të qytetit Patos njihet ndryshe si zona naftëmbajtëse Patos-Marinëz. Pjesë e kapitali natyror në Roskovec është stoku i burimeve natyrore si bimësia, uji, toka dhe biodiversiteti

⁶ Brown, D., and Ashman, D., 1996, 'Participation, social capital, and intersectoral problem solving: African and Asian cases', *World Development*, Vol24 No 9: 1467-79

që gjenerojnë shërbime të ekosistemit për prodhimin e ushqimit. Gjithashtu, praktikat e menaxhimit të tokës dhe sistemet që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet, me vlerën e natyrshme dhe kapacitetin prodhues, përbëjnë një aset për t'u konsideruar dhe llogaritur.

2.8 KAPITALI FINANCIAR I BASHKISË ROSKOVEC

Bashkia Roskovec ka një buxhet vjetor që arrin në 600,979,622 lekë. Ky buxhet është i përbërë nga transfertat qeveritare (transferta e pakushtëzuar e përgjithshme) në vlerën 115,118,589 lekë. Buxheti nga transfertat sektoriale është në vlerë 62,311,131 lekë. Por një zë me rëndësi në buxhet domethënëse për kapitalin financiar janë të ardhurat e veta që për vitin 2021 arrijnë në 272,036,000 lekë.⁷ Ndërkohë bashkia ka dhe një borxh prej 175,882,374 lekë në fund të vitit 2021.

Gjatë viti 2021, bashkia Roskovec ka realizuar 214,999 mijë lekë të ardhura të veta, ndër të cilat 175,404 mijë lekë ose 81.6% janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2020, të ardhurat e bashkisë Roskovec, janë rritur me 25.8%.⁸ Taksat kryesore të cilat zënë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave të veta janë: taksa mbi ndërtesën e cila përbën 71% të totalit; taksa mbi tokën bujqësore e cila përbën 17% të totalit.

Në vitin 2021, bashkia Roskovec me një popullsi prej 25,048 banorë ka realizuar në total 482,538 mijë lekë shpenzime. Në krahasim me vitin paraardhës, këto shpenzime janë rritur me rreth 30% ose 117,782 mijë lekë që ishin në vitin 2020. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet sipas Wklasifikimit ekonomik, në mijë lekë.

Tabela 2. Shpenzimet e bashkisë Roskovec sipas natyrës

Shpenzimet e NJQV sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferenca 2021-2020	Raporti i ndryshimit
	2021	2020	2019	2018		
Shpenzime korrenti	292.460	253.866	256.355	244.607	38.594	15%
Personeli	193.423	182.496	184.739	165.642	10.927	6%
Operative	70.679	69.725	69.265	74.932	953	1%
Të tjera	28.359	1.645	2.351	4.033	26.713	1624%
Shpenzime kapitale	190.078	116.890	159.446	243.301	73.189	63%
TOTALI	482.538	370.756	415.800	487.908	111.782	30%

⁷ Ministria e Financave. Buxheti Vendor 2021. www.financa.gov.al

⁸ Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raport Vjetor. Financat Publike Vendore 2021. Fq.170

2.9 SISTEMET TERRITORIALE

Bashkia Roskovec në Planin e Përgjithshëm Vendor të miratuar në KKT më datë 10.06.2020 prezanton këtë sistem territorial, të cilët përbejnë:

Tabela 3. Shpërndarja Urbane

Sistemi	Të dhënat ekzistuese		Të dhëna e propozuara	
	Sipërfaqe	%	Siperfaqe	%
Sistemi urban-ub	1393.08	11.04	1529.78	12.12
Sistemi infrastrukturore-in	148.71	1.17	192.21	1.52
Sistemi bujqësore -b	10156.65	80.54	9974.97	79.1
Sistemi natyrore-n	742.23	5.88	743.71	5.89
Sistemi ujqor-u	173.99	1.37	173.99	1.37

3. IDENTIFIKIMI I BURIMEVE NATYRORE

3.1 BURIMET MINERARE

Bazuar në të dhënat e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, burimet minerare në territorin e bashkisë Roskovec, raportohen të jenë të pakta dhe pa ndonjë vendburim në veçanti të studiuar⁹ (Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, 2015). Gjithashtu në territorin e bashkisë Roskovec nuk operon aktivitete asnjë shoqëri në fushën e kërkim zbulimi ose shfrytëzimit.

ENERGJIA

Energjia me bazë karboni

Territori i bashkisë Roskovec shtrihet në zonën e fushës naftëmbajtëse të Patos-Marinzës. Kjo zonë është e njohur për cilësinë dhe sasinë e lartë të hidrokarbureve. Prej këtij vendburimi shfrytëzohen naftë dhe gaz shoqëruar, të cilët trajtohen në mënyrë industriale brenda vendit dhe jasht tij.

Zona Patos Marinzë

Vendburimi i naftës në këtë zonë është zbuluar fillimisht në vitet 1920, por vetëm pas luftës së dytë botërore ka filluar aktiviteti i shpimit të parë dhe shfrytëzimit të tij. Që prej vitit 1950 në këtë zonë janë hapur më shumë se 2400 puse me thellësi prej 300-1900 m. Pjesa më e madhe e puseve nuk janë aktualisht në përdorim ndërsa një pjesë akoma më e madhe prodhon naftë në sasi të ulëta¹⁰.

Ky vendburim, ndodhet në juglindje të Ultësirës Pran Adriatike. Formacioni i Drizës në monoklinalin e Patos-Marinzës u zbulua në vitin 1928, dhe në të njëjtën kohë u zbulua dhe vendburimi i naftës Kuçovë në depozitimet e Neogenit të muldës së Kuçovës. Sipërfaqja e formaconit Driza ka ardhur vazhdimisht duke u rritur me shpimin e puseve të rinj dhe në vitin 1957 u zbuluan edhe dy formacione, Marinza Nr.1 dhe Marinza Nr.2 në depozitimet e Tortonianit të vendosura nën formacioni Driza. Përhapja e këtyre shtresave naftëmbajtëse është e provuar në drejtimet veri dhe veriperëndim, ku rezervat e tyre vlerësohen të limituara.

Tabela 4. Sasia e Rezervave Gjeologjike ne Patos Marinzë

Nr.	Lloji Rezervave	Sasia/Ton
1	Rezervat gjeologjike	258,393,913.0
2	Rezervat fillestare të nxjerrëshme	31,120,186.0
3	Rezerva te shfrytëzuara (1/10/2018)	28,350,718.0
4	Rezervat të nxjerrëshme (1/10/2018)	2,769,468.0

⁹ Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, 2015

¹⁰ (Atelier 4, 2020)

Koncesioni i Vendburimit Patos Marinzë

Kjo zonë shtrihet ndërmjet bashkive Fier, Patos dhe Roskovec, dhe administrohet nëpërmjet “Licencës - Marrëveshja për Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në vendburimin e naftës Patos-Marinza”, e cila ka hyrë në fuqi në datën efektive 20 korrik 2004, fillimisht me operator Saxon International Energy Ltd deri në fund të vitit 2006 dhe që prej vitit 2007 me operator kompaninë Bankers Petroleum Albania. Aktualisht kjo licencë është në fazën e zhvillimit e prodhimit të vendburimit¹¹. (Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore , 2021).

Përsa i përket raportimeve të kryera nga vetë shoqëria shfrytëzuese, ato janë të pakta dhe jo të përditësuara. Rezervat e mbetura të këtij vendburimi të deklaruar nga shoqëria Bankers Petroleum Albania në vitin 2010 llogariten në (Banker Petroleum Albania, 2011):

Tabela 5. Rezervat e llogaritura nga Bankers Petroleum

Nr.	Lloji Rezervave (2010)	Sasia (fuçi)	Sasia m3
1	Burime të provuara	1.2 miliardë	190,000,000
2	Rezervat fillestare të nxjerrëshme	568 milion	90,300,000

Përfitimet nga Shfrytëzimi

Aktiviteti i shfrytëzimit të vendburimit të naftës në Patos – Marinzë, sjell një përfitim të madh në shkallë kombëtare por edhe në aspektin lokal. Për këtë duhet theksuar se sasia e naftës të nxjerrë nga ky vendburim është e barasvlershme me 88% të prodhimit të brendshëm. Gjithashtu duhet theksuar edhe përfitime ekonomike nga të ardhurat e rentës minerare si dhe punësimit të banoreve të zonës.

Tabela 6. Të dhëna nga shfrytëzimi hidrokarbur në Patos Marinzë

Përfitimet nga Shfrytëzimi	Sasia	Viti
Sasia e prodhimit (ton)	885.6 mijë	2019
	674.2 mijë	2020
Rentë minerare të shfrytëzimit	14,063,000 \$	2020
Rentë minerare për Bashkinë Roskovec	24,982,104 Lekë	2018
Numri i punonjësve	463 vendas dhe 32 të huaj	2020

ENERGJIA E RINOVUESHME

Energjia Diellore

Zona e bashkisë Roskovec është me karakter fushor dhe kodrinor, e shtrirë në një sipërfaqe prej 118 Km². Bashkia Roskovec është një prej zonave që shikohet si me potencial të lartë rendimenti në prodhimin e energjisë nga burimet diellore. Kësisoj në përlllogaritjen e sipërfaqes së mundshme për përdorim të impianteve fotovoltaike do të merren për bazë vetëm sipërfaqet e tokës të llojit shkurre, sipas legjislacionit dhe udhëzime përkatëse nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Gjithashtu ekziston mundësia edhe e përdorimit të tokave bujqësore për instalimin e paneleve diellore, kjo mund të

¹¹ Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore , 2021

realizohet në mënyrë të drejtë për drejtë, ose në mënyrë të kombinuar me përdorimin e serave.

Potenciali energjetik diellor në zonën e bashkisë Roskovec, përlogarit të jetë 1450-1650 kWh/m² me një diellëzim maksimal prej 2700 orë për një sipërfaqe maksimale të përdorshme prej 130 ha.

3.2 BURIMET UJORE

Ujërat sipërfaqësorë

Sasia e ujerave sipërfaqësore në bashkinë e Roskovecit është relativisht e ulët, ku pjesën më të madhe e zë liqeni i Kurjanit i ndjekur më pas nga disa përrenj të cilët përdoren kryesisht për vaditje të tokave. Prurjet vjetore janë relativisht të ulëta nga 5-30 m³/s. Pjesa më e madhe e këtyre prurjeve grumbullohet në rezervuarin e Kurjanit që përbën dhe sipërfaqen ujore më të madhe në territorin e bashkisë¹².

Ujërat nëntokësore

Territori i Bashkisë Roskovec, në tërësi nuk është i pasur me ujera nëntokësore. Sikurse raportohet edhe nga studimet hidrogjeologjike të kryera, pjesa më e madhe e territorit mbulohet nga shtresa ujëmbajtëse të varfëra ose shumë të varfëra në ujëra nëntokësore. Shtresat më të pasura ujëmbajtëse përhapen në një sipërfaqe të vogël dhe kryesisht mund të përdoren për përdorime vetjake dhe jo për shpërndarje të gjerë urbane apo industriale. Shfrytëzimi i ujerave nëntokësore kryesisht realizohet nëpërmjet puseve të shpimit me thellësi deri 200m dhe me anë të pompave mund të japin nga 0.5-5 l/s ujë¹³.

3.3 PARQET

ZONA MJEDISORE

Këneta e Zezë

Këneta e zezë ndodhet në afërsi të fshatit Strum dhe përbën rëndësi të veçantë për faktin se është një zonë e cila i ka mbijetuar bonifikimit të tokës të ndodhur në vitet 1970. Përpara kësaj periudhe ajo ishte pjesë e një baseni të madh kënetor, por që sot ka mbetur vetëm një sipërfaqe prej 3 Ha nën ujë. Kjo sipërfaqe toke është monument natyror me veçori origjinale si para shume vitesh, me bimësi kallamash nënujor, peshq, shpendë dhe karakteristikë ujin e zi i cili nuk shteron¹⁴

ATRAKSIONET TURISTIKE

Kisha e Shën Kollit

Kisha ndodhet në zonën e Kurjanit, dhe është ndërtuar në shekullin e XIII, është monument kulture e shpallur prej vitit 1970. Ajo është e ndërtuar në stilin bizantin. Në brendësi të saj gjendjen piktura murale të cilat janë vepra të ikonografit Nikolla, biri i Onufrit dhe ndihmësit të tij, Joanit.

¹² Atelier 4, 2020

¹³ Atelier 4, 2020

¹⁴ Atelier 4, 2020

Kisha e Shën Gjergjit

Kisha ndodhet në zonën e Strumit, dhe është ndërtuar në shekullin XVII, ajo ndodhet pranë një bregoreje të butë dhe e veshur me gjelbërim. Kjo kishë ka një gjatësi prej 10 metra dhe lartësi 3.5 metra. Pjesa me e rëndësishme e saj është padyshim këmborja e cila mbart vlera të larta të trashëgimisë kulturore fale punimit të saj të veçante.

3.4 PYJET

Territori i bashkisë Roskovec, përbëhet nga një terren kodrinor i cili në pjesën jugore të tij ka dhe një pjesë pyjore e cila përfshin një sipërfaqe totale prej 2,737 Ha dhe pjesën më të madhe është Pyll.

Tabela 7. Sipërfaqet e Pyjeve, Bashkia Roskovec

Nr.	Lloji	Lloji Burimeve Pyjore (ha)
1	Pyje	2,528
2	Trungishte	78
3	Cungishte	80
4	Shkurre	4
5	Bimësi Pyjore	46
	TOTAL	2,737

3.5 BUJQËSIA DHE BLEGTORIA

Bashkia Roskovec është një bashki rurale, ku jo vetëm struktura e popullatës por edhe struktura ekonomike ka një drejtim të theksuar rural. Si bashki ka një koeficient të ulët të sipërfaqeve të pa kultivuara, vetëm 42 Ha ose 0,5% të sipërfaqeve bujqësore. Baza e prodhimit bujqësor në territorin e bashkisë Roskovec janë drithërat me destinacion për konsum të familjeve të rajonit dhe për ushqim koncentrat për blegtori. Këto prodhime të freskëta dhe të përpunuara i drejton në destinacionin e tregut rajonal të Fierit dhe atë kombëtar.

Bujqësia

Territori i bashkisë Roskovec është i njohur për prodhimtarinë e lartë bujqësore. Kjo bashki ka një sipërfaqe toke bujqësore prej 8,533 Ha, të cilat prodhojnë produkte të shumëllojshme. Gjithashtu në zonën e Roskovecit janë ndërtuar dhe 580 sera diellore me një sipërfaqe prej 160ha.

Tabela 8. Sipërfaqet e Tokës Bujqësore sipas Njësi Administrative, Bashkia Roskovec

Përdorimi i Tokës sipas NJ.A	Tokë Bujqësore
Njësia Roskovec	1264.2
Njësia Strum	2680.9
Njësia Kuman	2319.8
Njësia Kurjan	2268.1
Total	8,533 Ha

Në prodhimtarinë bujqësore të bashkisë Roskovec, përfshihen llojet e pemëve frutore (Mollë, Kajsi, Fiq, Hurma, etj.), perime të njoma e të thata, drithëra, foragjere, etj. Ndër prodhimet më të spikatura të zonës janë produktet e fruta perimeve si: kastravec, domate, patate, kungull, lakër, luleshtrydhe, pjepër, kajsi, qepë, fasule, etj., të cilat shkojnë në një sasi vjetore prej 5 mijë ton.

Tabela 9. Shumëllojshmëria e prodhimeve bujqësore

Nr	Emërtimi	Sipërfaqe Ha	Rend Kv/Ha	Kulturë e l	I+II+Bashkë- shoqëruese
A	Drithëra bukë gjithë kult.l-rë	1,970	45.0375	9,668	
	1.Grurë	1,040	43.75	4,541	4,541
	2.Misër	650	67.2	4,365	4,935
	3.Elë	30	44	132	132
	4.Tagjira	250	25.2	630	630
B	Perime gjithsej	250	25.2		
I	Perime fushe	0	0	0	0
	1.Perime të njoma	0	0	0	0
	2.Perime të thata	0	0	0	0
	3.Bostane	0	0	0	0
II	Serra	80	0	0	0
C	Patate	160	0	900	144,000
D	Fasule direkte	0	0	0	0
E	Kultura industriale gjithsej	0	0	0	0
	duhan	6	20		20
G	Bimë Medicinale	2.5	0	0	0
	Sherebelë	2.5	10	10	0
F	Foragjere të njoma	4,515.05	1,006.43	5,850	136,280
	Jonxhë gjithsej	2,990	335.35	0	100,270
	Nga kjo:-Jonxhë e re	370	171.09	0	6,330
	Misër foragjer	420	264.76	0	19,160
	Hasëll/ lakër foragjere	450	30	0	450
	Të tjera	285.05	205.23	5850	10,070
	Foragjere nga toka djerr, kullota	70	40	70	0
	Kullota	30	15	30	
	Sipërfaqe gjithsej e mbjellë	6,807.55	1,116.6675	15,588	136,280

Tabela 10. Shumëllojshmëria e Pemëve Frutore

Nr.	Pemë frutore	Prodhimi ton
1	Mollë	768.30
2	Dardhë	387.92
3	Ftonj	49.60
4	Kumbulla	159.25
5	Qershi	83.73
6	Pjeshke	352.77
7	Kajsi	60.35
8	Fiq	399.41
9	Hurma	73.94
10	Shegë	69.63
11	Mana	6.05
12	Arra	9.18
13	Lajthi	12.60
14	Rrush	2,573.60
15	Tjera	3.22
	Total	5,009.55

Ullishtet zënë një sektor me prodhimtari dhe me të ardhura të konsiderueshme. Shtrihen në një sipërfaqe me rreth 1684.3 Ha. Prodhimi i ullirit kryesisht përpunohet për vaj në 6 fabrikat që ndodhen në zonën e Roskovecit.

Pemët frutore zënë një sipërfaqe rreth 88.3 Ha nga ku 25.270 kv fruta merren si prodhim i 113.654 rrënjëve. Vreshtat zënë një sektor në rritje nga ku merret 16.079 kv rrush ne 136.8 Ha vreshta.

Tabela 11. Shumëllojshmëria e Agrumeve

Nr	Emërtimi	Gjithsej rrënjë
II	Ullinj (gjithsej)	259,600
	Nga këta për tavolinë	44,470
III	Agrume (gjithsej)	130,270
1	Portokalle	122,390
2	Limon	4,215
3	Mandarina	3,665
4	Vreshta	449,470

Tabela 12. Llojet e të mbjellave

Nr	Emërtimi	Sipërfaqe Ha	Rend Kv/Ha	Prodhimi në Ton
A	Drithëra buke	1,970.00	49.03	96,589.10
B	Perime njoma/thata	487.65	503.04	245,307.46
C	Patate	90.00	0	144,000
D	Fasule direkte	125.00	12.00	1,500.00
G	Foragjere të njoma	3,695.05	317.29	1,172,402.4
	Total	6,367.70	1,054.75	6,716,331.6

Blegtoria

Bashkia e Roskovecit, në territorin e saj ka edhe një numër të lartë burimesh blegtorale ku përfshihen kafshë të shumëllojshëm. Prodhohet rreth 19.400 ton qumësht si bashki. Rendimentet e qumështit janë të kënaqshme edhe për të imtat ku mund të themi që prodhimtaria për krerë është më e lartë se e vendit. Blegtoria është dega më e rëndësishme e prodhimit ekonomik të fermave rurale private në territorin e Bashkisë Roskovec. Kjo vërehet jo vetëm nga struktura e numrit të krerëve në territor por edhe të raportit 60:40 kundrejt prodhimit bujqësor.

Gjithashtu, bletaria është një sektor me shumë të ardhme dhe që po rritet ndjeshëm pothuaj në gjithë territorin. Mjalti është një nga produktet e rëndësishme të prodhimit blegtoral i shpërndarë në të gjithë vendin, si edhe gjithashtu prodhohen rreth 5.6 milion kokrra vezësh¹⁵.

Tabela 13. Shumëllojshmëria blegtorale

Nr.	Lloji	Sasia (2021)
1	Të leshta	9,300
2	Të dhirta	2,010
3	Gjedhë	3,980
4	Derra	325
5	Një thundrake	550
6	Shpendë	46,000
7	Bletë	1,000

3.6 BIODIVERSITETI

Fauna dhe Fauna

Në territorin e bashkisë Roskovec, bazuar në studimet e kryera, rezulton të këtë një përbërje të faunës të llojeve të gjitarëve, shpendëve shtëpiake, gjithëfarë për përdorim bujqësie, faune e egër (insekte, reptilë, gjitarë, shpendë) të fushave, fauna e pyjeve si dhe amfibë të ujërave të ëmbël. Përsa i përket faunës

ujore, me rëndësi ekonomike janë peshqit të cilët jetojnë në ujërat e lumenjve të mëdhenj, si dhe tek rezervuarët, si psh. Mlyshi, Mustaku, Amur, Ballëgjerë, etj. Ndërsa nga shumëllojshmëria e shpendëve duhet të përmendim kryesisht Rosat (Rosa e vendit, rosa e vogël, bishtgjela) si dhe patat (ballëbardhë, pata e përhimet, belba)

Tabela 14 Shumëllojshmëria e peshqve dhe produkteve ujore

Nr.	Peshku dhe produkte të tjera ujore (Peshk i ujerave të ëmbla)	Kv
1	Krapi	40
2	Karasi	70
3	Sardele	50
4	Ball Gjerë i bardhë	120
5	Ball Gjerë Larosh	40
6	Amuri	35
7	Zvarranik (Ngjalë)	10
8	Pëllëmbëz	10
9	Bretkosa	0

Një tjetër aktivitet i cili ka zënë vend kohët e fundit, është edhe kultivimi i peshkut. Këto struktura janë të vogla dhe kryesisht rrisin peshk në sasi të vogla tregtuese. Llojet e tyre janë Krapi, Ballëgjeri i bardhë/ larosh dhe Amuri.

Gjithashtu në shumëllojshmërinë e gjallesave të egra dhe bimëve në territorin e bashkisë Roskovec, të cilat raportohen si me poshtë por për të cilat nuk janë kryer evidentime dhe matje të sakta.

Tabela 15 Shumëllojshmëria e Florës dhe Faunës

Nr.	Zonat dhe speciet e Mbrojtura	Kategoria	Vendndodhja
I Fauna e Egër			
1	Mëllënj	Shpend	Gjithë territori
2	Skifter i kthetra verdh	Shpend	Gjithë territori
3	Skifter i kthetrazi	Shpend	Gjithë territori
4	Skifteri i vogël	Shpend	Gjithë territori
5	Felleze	Shpend	Gjithë territori
6	Shkurtëz	Shpend	Gjithë territori
7	Shapkë	Shpend	Gjithë territori
8	Shapkë e ujit	Shpend	Liq i Kurjanit/Këneta e zezë
9	Zarigoge	Shpend	Gjithë territori
10	Rose e eger	Shpend	Liq i Kurjanit/Këneta e zezë
11	Bajze	Shpend	Liq i Kurjanit/Këneta e zezë
12	Dallëndyshe	Shpend	Gjithë territori
13	Pulëbardhe	Shpend	Liq i Kurjanit
14	Bilbil	Shpend	Gjithë territori
15	Pulë e egër	Shpend	Gjithë territori

16	Kumri	Shpend	Gjithë territori
17	Gjon	Shpend	Gjithë territori
18	Trumcak	Shpend	Gjithë territori
19	Larask	Shpend	Gjithë territori
20	Sorrë	Shpend	Gjithë territori
21	Bufi	Shpend	Gjithë territori
22	Kredharaku gushëzi	Shpend	Gjithë territori
23	Kredharaku i vogël	Shpend	Gjithë territori
24	Roza pikaloshe	Shpend	Liqeni i Kurjanit/Këneta e zezë
25	Rosa e zezë krahë bardhë	Shpend	Liqeni i Kurjanit/Këneta e zezë
26	Rosa e zezë	Shpend	Liqeni i Kurjanit/Këneta e zezë
27	Rosa kokëbardhë	Shpend	Liqeni i Kurjanit/Këneta e zezë
28	Rosa laramane	Shpend	Liqeni i Kurjanit/Këneta e zezë
29	Pata e egër	Shpend	Liqeni i Kurjanit/Këneta e zezë
30	Rosa e ngricave	Shpend	Liqeni i Kurjanit/Këneta e zezë/kanale
31	Turtulli	Shpend	Gjithë territori
32	Gjeraqinë	Shpend	Gjithë territori
33	Thëllëza e fushës	Shpend	Gjithë territori
34	Pëllumbi i egër i pyllit	Shpend	Liqeni i Kurjanit/Këneta e zezë/kanale
35	Gjelëz	Shpend	Këneta e zezë
36	Qyrylyk	Shpend	Liq i Kurjanit/Këneta e zezë
37	Kukuvajk	Shpend	Gjithë territori
38	Bilbil uji	Shpend	Liq i Kurjanit/Këneta e zezë/kanale
39	Gargulli	Shpend	Gjithë territori
40	Pupëza	Shpend	Gjithë territori
41	Lauresha me brirë	Shpend	Gjithë territori
42	Cerri	Shpend	Gjithë territori/kanale
43	Gushëkuqi	Shpend	Gjithë territori
44	Bishtundës me ngjyrë limoni	Shpend	Gjithë territori
45	Gardalinë	Shpend	Gjithë territori
46	Kanarinë	Shpend	Gjithë territori
47	Breshkë uji	Kafshë	Kanale, gjithë territori
48	Hardhucë (Shpinë gjelbër)	Kafshë	Gjithë territori
49	Bretkosë	Kafshë	Gjithë territori
50	Thithlopë	Kafshë	Gjithë territori
51	Zhapik	Kafshë	Gjithë territori
52	Lakuriq nate	Kafshë	Gjithë territori
53	Lundërza	Kafshë	Gjithë territori
54	Baldosa	Kafshë	Gjithë territori

55	Lepur	Kafshë	Zona kodrinore
56	Dhelpër	Kafshë	Gjithë territori
57	Nuselale	Kafshë	Gjithë territori
58	Ujk	Kafshë	Zona kodrinore
59	Breshka	Kafshë	Gjithë territori
60	Gjarpër	Kafshë	Gjithë territori
61	Qelbës	Kafshë	Gjithë territori

II Flora e Mbrojtur, Monumentet Natyrore

1	Pisha e zezë	Pylli i Luarit/Pylli I Kurjanit
2	Salvinie notuese	Këneta e zezë
3	Shavar i vogël	Këneta e zezë

4. VLERËSIMI MONETAR I BURIMEVE NATYRORE

Kapitali natyror përfaqëson stokun e burimeve natyrore të një vendi, i cili përfshin ajrin, ujin, mineralet dhe të gjitha gjallesat. Këto burime natyrore ofrojnë një gamë të gjerë përfitimesh për shoqërinë dhe ekonominë të cilat shpesh njihen si “shërbime eko-sistemi”. Nisur nga përfitimet që burimet natyrore krijojnë për një vend është e rëndësishme që vlera ekonomike e tyre, specifikuisht fluksi monetar vjetor dhe vlera e aktivitet monetar, të llogariten për të përcaktuar ndikimin e burimeve natyrore në mirëqënien e kapitalit njerëzor.

Për të matur vlerën e aktiveve monetare, ekzistojnë qasje të ndryshme por ajo më e përdorura bazohet në konceptin e vlerës aktuale neto, koncept i cili përlogarit vlerën e kapitalit natyror përmes aktualizimit/diskontimit të vlerave të ardhshme vjetore të shërbimeve të ekosistemit të gjeneruara gjatë një periudhe kohore të përcaktuar.

Në rastin kur çmimet e tregut për një burim natyror nuk ekzistojnë, ato vlerësohen bazuar në supozime dhe modele të ndryshme.

4.1 BURIMET MINERARE

Ashtu sic u evidentua edhe më parë, specifikuisht në seksionin 3, burimet minerare të bashkisë Roskovec janë pothuajse inekzistente.

ENERGJIA

Energjia me bazë karboni

Identifikimi i burimeve energjetike të Roskvecit, seksioni 3, nxjerr në pah të drejtën e kësaj bashkie mbi fushën naftë mbajtëse të Patos-Marinzës. Vlerësimi i kësaj të drejte për nga pikëpamja kontabël apo sasiore bëhet i vështirë në mungesë të një ndarje të qartë të bashkive që kanë të drejta mbi këtë burim energjetik, si Fier, Patos dhe Roskovec. Një përpjekje është bërë nga ana e eksperteve që të vlerësojnë rezervat për të gjithë fushën naftëmbajtëse pa bërë ndarjen e fluksit dhe aktivitet monetar mes bashkive në mungesë të të dhënave shtesë.

Bashkia Roskovec raporton rezerva të arritshme dhe ende të pashfrytëzuara në 2,769,468 ton (në vitin 2018) dhe një prodhim vjetor prej mesatarisht 779,900 ton. Duhet vënë në dukje që kjo sasi duhet të ketë pasaktësi përderisa kemi vazhdim të nxjerrjes edhe sot, ç’ka tregon se rivlerësimi i rezervave të naftës është një proces i vazhdueshëm që në varësi të sistemit të matjeve dhe mjeteve rezulton në përfudime të ndryshme.

Në vlerësimin tonë si çmim referencë është konsideruar çmimi në bursë i BRENT Crude oil, 809.4 USD/ton konvertuar në ALL me kursin e BoA datë 23.06.2022. Duke qenë se nafta në Shqipëri është e një cilësie më të ulët, çmimi është 25%-50% më i ulët se i Brent Crude Oil për këtë arsye është supozuar një vlerë mesatare prej 40% më e ulët. Llogaritjet e prodhimit vjetor janë bazuar në një mesatare të prodhimit vjetor të vitit 2019 dhe 2020. Llogaritjet për fushën naftëmbajtëse japin një rezultat në terma të aktivitet monetar dhe fluksit monetar prej 153 miliardë lekë dhe 43 miliardë lekë, respektivisht.

Tabela 16. Vlera e prodhimit dhe rezervave të naftës

Lloji	Njësia matëse	Sasia	Çmimi në lekë	Vlera në lekë
Naftë (vlera e aktivitet)	Ton	2,769,468	55,222	152,935,906,418
Naftë (fluksi monetar)	Ton	779,900	55,222	43,067,734,820

Energjia e Rinovueshme

Duke pasur parasysh kushtet e përshtatshme klimaterike që bashkia Roskovec ka për ta zhvilluar këtë burim energjie, ekipi i punës ka bërë një përlogaritje të potencialit energjetik të bashkisë nga energjia e rinovueshme dhe më specifilisht nga energjia fotovoltaike.

Supozimet e përdorura:

Tokat e mbjella me trungishte, cungishte, shkurre dhe bimësi pyjore do të përdoren për ndërtimin e paneleve diellore. Përfshihen tokat pyjore dhe bujqësore;

Sipërfaqja e m² të paneleve do të jetë e barabartë me sipërfaqen në Ha të trungishteve, cungishtave, shkurreve dhe bimësisë pyjore e cila rezulton 208 Ha;

Çmimi 24.89 Euro / MWH i ofruar në tenderin për parkun fotovoltaike te Karavastasë.

Analiza e mësipërme me të dhënat e bashkisë dhe supozimet e ekspertëve na çon në vlerën e fluksit monetar vjetor prej LEK 9.2 mld dhe aktivitet nga energjia fotovoltaike prej 98 miliardë lekë.

Tabela 17. Vlera e fluksit monetar vjetor dhe aktivitet monetar nga energjia fotovoltaike

Lloji	Njësia matëse	Sasia	Çmimi në lekë	Vlera në lekë
Fotovoltaike (Diell)	kWh/m ²	1450-1650	2,975	9,281,540,736

4.2 BURIMET UJORE

UJËRAT SIPËRFAQËSORË

Burimet ujore të bashkisë Roskovec janë të kufizuara dhe të dhënat për lumin kryesor, Seman, mungojnë. Potencialin e burimeve ujore mund ta masim në këto kushte duke vlerësuar potencialin për vaditje të liqeneve të Kurjanit dhe Ngjeçarit dhe të disa përrrenjve të vegjël si Vidhishte dhe Donofros.

Llogaritjet janë bazuar në VKM nr. 662, datë 21.9.2016, ku tarifa e përdorimit të ujërave për ujitje në bujqësi përcaktohet 2.5 lekë/m³. Potenciali i të ardhurave vjetore (fluksi vjetor) nga tarifat e vaditjes për bashkinë arrin në 65.8 milionë lekë ndërsa aktivitet monetar nga po i njëjti përdorim i ujërave sipërfaqësore në 1,19 miliardë lekë (9 milionë Euro).

Tabela 18. Vlera e fluksit monetar vjetor nga burimet ujore

Lloji	Sasia (0000/m3)	Çmimi për vaditje (lekë/m3)	Vlera totale
Lumenjtë	-	-	-
Lumi Seman	-	-	-
Liqenet dhe Rezervuarët	-	-	-
Rezervuari i Kurjanit	25,000,000	2.5	62,500,000
Rezervuari i Ngjeqarit	180,000	2.5	450,000
Përrenj	-	-	-
Përroi i Allambrezit	-	-	-
Përroi i Buallit	-	-	-
Perroi i Vidhishtës	40/s	2.5	1,261,440
Përroi i Donofros-Velmish	50/s	2.5	1,576,800
Total			65,788,240

4.3 PARQET

Edhe pse bashkia Roskovec ka disa atraksione turistike në territorin e saj, si Këneta e Zezë, Kisha e Shën Kollit dhe e Shën Gjergjit, ajo ende nuk ka në dispozicion ndonjë statistikë apo studim rreth potencialit turistik të këtyre parqeve.

4.4 PYJET

Bazuar në tabelën 7 në seksionin 3 më lart, bashkia Roskovec raporton një total prej 2,737 Ha pyje dhe bimësi pyjore. Nëse analizojmë burimet pyjore të bashkisë Roskovec, vëmë re disa përdorime të rëndësishme të tyre. Përdorimet më përfituese dhe më të përshtatshme për natyrën e Roskovecit janë përzgjedhur:

- a. Për lëndë drusore;
- b. Për të drejta emetimi karboni/sekuestrim karboni;
- c. Dhe për dhënien me qira për 3 përdorime të mundshme:
 - i. Për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme;
 - ii. Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut;
 - iii. Për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike kampingje (kënde lodrash, mjedise sportive, shlodhëse etj.)

Fatkeqësisht, mungojnë të dhënat për mundësinë e përdorimit të pyjeve si lëndë drusore. Nëse vlerësojmë përdorimin e dytë të listuar më lart, pra sekuestrim karboni, në bazë të raporteve të bashkisë rezulton një e ardhur e mundshme përmes aftësisë së pyjeve për të sekuestruar karbonin që emetohet në natyrë ose nëpërmjet tregtimit të drejtave për emetim karboni.

Tabela 19. Vlera e burimeve pyjore në rast përdorimi për sekuestrim karboni

Lloji	Lloji Burimeve Pyjore ha	Karbon për Ha/kg	Karbon në tokë për Ha/kg	Vlera e emetimit të krediteve (lekë/Ton)	Kapja e karbonit (lekë/Ton)	Vlera nëse prodhim karboni	Vlera nëse kapja e karbonit
Pyje	2,528	9,000		9,222	7,028	209,828,294	159,909,788
Trungishte	78	2,000		9,222	7,028	1,444,110	1,100,553
Cungishte	80	2,000		9,222	7,028	1,473,434	1,122,902
Shkurre	4	2,000		9,222	7,028	78,384	59,736
TOTAL						197,704,283	158,163,427

Çmimi për njësi për prodhim karboni është marrë nga përlogaritjet e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN-së) prej rreth 75 USD/ton, ndërsa vlera për sekuestrim karboni është marrë nga publikimi i Keneth Richards dhe Robert Stanvins – ‘The cost of US forest based carbon sequestration’.

Në bazë të të dhënave më lart, arrijmë në një vlerë tregu konservative prej 162,192,980 lekë në vit si fluks monetar vjetor. Kjo vlerë do të rezultonte në një vlerë totale të aktivitetit pyjor prej 2.1 miliardë lekë (18 milion Euro).

Nëse përcaktojmë vlerën e aktivitetit pyjor nga pikëpamja e përdorimit për t'i dhënë me qira për funksione të ndryshme atëherë bazuar në çmimet minimale të referencës të përcaktuara në VKM 1064, datë 22.12.2010 për sipërfaqet e raportuara nga bashkia rezultojnë vlerat në tabelën vijuese:

Tabela 20. Të ardhura vjetore të mundshme nga burimet pyjore në rast përdorimi për dhënie me qira

Lloji Burimeve Pyjore	Sipërfaqja në HA	Çmimi për Ha/vit sipas VKM 1064, 22.12.2010			Të ardhura vjetore të mundshme		
		Për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme	Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut	Për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike kampingje (kënde lodrash, mjedise sportive, shlodhëse etj.)	Për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme	Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut	Për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike kampingje (kënde lodrash, mjedise sportive, shlodhëse etj.)
Pyje	2,528	22,333	33,333	133,583	56,463,357	84,273,667	337,726,719
Trungishte	78	22,333	33,333	133,583	1,748,700	2,610,000	10,459,575
Cungishte	80	20,100	22,333	97,000	1,605,789	1,784,210	7,749,330
Shkurre	4	20,100	22,333	97,000	85,425	94,917	412,250
Bimësi pyjore	46	12,000	15,000	45,000	552,000	690,000	2,070,000
Totali	2,737				60,455,271	89,452,793	358,417,874

Tabela 21. Vlera e aktivitet pyjor në rast përdorimi për dhënien me qira

Vlera e aktivitet pyjor në lekë		
Për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme	Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut	Për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike kampingje (kënde lodrash, mjedise sportive, shlodhëse etj.)
366,263,215	541,942,287	2,178,867,775

Vlera e aktivitet pyjor mund të maksimizohet nëpërmjet dhënies me qira për qëllime pushimi, argëtimi dhe veprimtari turistike deri në vlerën prej 2.179 miliardë lekë (19 milion Euro) njëkohësisht duke shërbyer edhe për sekuestrimin e karbonit.

4.5 BUJQËSIA DHE BLEGTORIA

BUJQËSIA

Fondi tokave të bashkisë Roskovec raportohet kryesisht si i cilësisë IV dhe V, pra konsiderohen toka të një cilësie jo ndër më të lartat. Për këto kategori tokash kemi aplikuar çmimin e qirasë të aplikuar nga bashkia i cili është më i lartë se ai minimal indikativ i qirasë që sugjerohet nga VKM nr. 373 datë 20.06.2018.

Tabela 22. Vlera e fondit të tokave në rast përdorimi për dhënien me qira

KLASIFIKIMI I TOKAVE	Sipërfaqe Ha	Vlera e qerasë në vit lekë/ha	Totali vjetor i qirasë sipas bashkisë	Vlera aktuale e skontuar sipas bashkisë
Kategoria III	600	30,000	600,000,000	600,000,000
Kategoria IV	4,000	25,000	2,857,142,857	857,142,857
Kategoria V	2,994	17,000	1,272,450,000	1,272,450,000
Kategoria VI	867	15,000	260,100,000	260,100,000
Total/mesatare	8,461		4,989,692,857	989,692,857

Supozime:

E gjithë sipërfaqja supozohet se është e dhënë me qira;

Norma e kapitalizmit 2%-6% në varësi të kategorisë së tokës;

Vlera e përgjithshme e tokave të mundshme për qiradhënie vlerësohet nga autorët në 2,589,696,429 lekë (22.2 milion Euro) me supozimin e anuitetit e të ardhurës vjetore dhe një normë kapitalizmi si më lart përmendur. Sigurisht, kjo vlerë do të përbënte vetëm minimumin e vlerësuar.

Tabela 23. Vlera e prodhimeve bujqësore

Emërtimi	Sipërfaqe Ha	Rend Kv/Ha	Prodhimi në Ton	Vlera (Lekë)
Drithëra buke	1,970	45	10,238	554,290,000
Perime gjithësej	250	25	-	-
Patate	160		144,000	7,200,000,000
Fasule direkte	125	12	0	0
Kultura industriale	6	20	20	5,000,000
Bimë medicinale	3	10	20	1,800,000
Foragjere të njoma	4,515	1,006	136,280	5,408,900,000
Pemë frutore				5,771,200
Ullinj (gjithësej)				295,092,000
Agrume (gjithësej)				68,355,160
Total				13,879,208,360

Tabela 24. Vlera e fluksit vjetor të prodhimeve blegtorale

Bagëtia	Ton	Krerë	lekë/kg ose çmimi i zëvendësimit	Vlera në lekë
Gjedhe për qumësht	18,060		50	361,200,000
Gjedhe për mish	1,102		550	242,440,000
Dele për qumësht	512	9,300	100	20,480,000
Dele për mish	335	9,300	550	73,700,000
Dhi për qumësht	3,221	2,010	50	64,420,000
Dhi për mish*	55	2,010	550	12,100,000
Derra	35	325	400	5,600,000
Bletë	5,800		1,200	2,784,000,000
Total fluksi vjetor				3,563,940,000

Të ardhurat vjetore nga produkti blegtoral arrijnë 3,563,940,000 lekë duke përdorur çmimet aktuale në tregjet bujqësore. Nga pikëpamja e stokut, nëse marrim parasysh një nivel kostos prej 40% të të ardhurave vjetor dhe një norme rritjeje vjetore prej 3.5% bashkë me një normë aktualizimi prej 10.33% për blegtori e bujqësi për Shqipërinë, si dhe duke shtuar vlerën e shpendëve dhe të njëhundurakëve në bazë të krerëve të raportuar arrijmë në një vlerë aktivi prej 53 miliardë lekë (451 milionë Euro).

4.6 BIODIVERSITETI

Fauna dhe Fauna

Përpyekjet për të vlerësuar llogarinë e aktiveve të faunës ndeshin në problematikën e të dhënave të detajuara si dhe në problematikën e përcaktimit të kufirit të bashkisë rreth të cilit kafshët e ndryshme qarkullojnë. Duke qenë se mjaft prej tyre mund të jenë të prirura t'i kalojnë kufijtë e bashkisë Roskovec, nuk është i mundur përfshirja dhe vlerësimi i tyre në llogaritë e KN, sidomos e kafshëve të egra.

Nga detajimi i mësipërm i faunës brenda biodiversitetit në seksionin 3.7 mund të veçojmë peshkimin, i cili madje mund të trajtohet si aktiv bashkë me bujqësinë e pylltarinë. Përsa i përket peshkimit, kapja vjetore raportohet në Tabelën 14 “Shumëllojshmëria e peshqve dhe produkteve ujore”. Nëpërmjet metodës së kërkimit për çmim referencë, mundem të gjejmë çmimin e peshqve karakteristik të ujërave të ëmbla. Bazuar në këto të dhëna mund të arrijmë në konkluzionin që fluksi vjetor i kapjes së peshkut arrin në rreth 9,175,000 lekë.

Tabela 25. Vlera e fluksit vjetor të kapjes së peshkut

Peshku dhe produkte të tjera ujore	Kapja bruto (Kv)	Cmimi lekë/kg	Vlera
Peshk			
Krapi	40	350	400,000
Karasi	70	100	700,000
Sardele	50	100	500,000
Ball Gjerë i bardhë	120	250	3,000,000
Ball Gjerë Larosh	40	250	1,000,000
Amuri	35	350	1,225,000
Zvarranik(Ngjalë)	10	800	800,000
Pëllëmbëz	10	550	550,000
Bretkosa	0	0	-
Total	375		9,175,000

5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

5.1 REZULTATET

Zbatimi i metodologjisë së vlerësimit të Kapitalit Natyror dhe praktikomi në bashkinë Roskovec përfundoi në disa rezultate konkrete të cilat po i rendisim si më poshtë vijon.

Koncepti i Kapitalit Natyror u mirëprit nga bashkia Roskovec. Institucionet qendrore dhe vendore e mbështetën qasjen e vlerësimit të Kapitalit Natyror dhe përfitimet e tij.

Bashkia Roskovec, mendoi në mënyrë të integruar rreth kapitalit natyror që ka në dispozicion duke u përpjekur të hartojë një listë të detajuar të kapitaleve të ndryshme e cila mund t'i përngjasë një censusi. Ky census nuk është thjeshtë një listë inventari fizik i pasurive, por edhe i funksioneve dhe fluksit të shërbimeve apo potencialit për shërbime i shoqëruar me analiza ekonomike mbi përdorimet alternative. Bashkia zotëron tashmë një metodike të vlerësimit ekonomik të kapitalit natyror për pjesën më të madhe të pasurive të saj tokësore edhe nëntokësore të ekosistemit, të ndërlidhura me njëra tjetrën, dhe lehtësisht të aksesueshme dhe të përditësuar nga vetë bashkia;

Rezultatet e vlerësimit janë paraqitur për ekosistemet pyjore, ekosistemet malore (infrastruktura e gjelbër) dhe ekosistemet e liqene, lumenj, përrenjve, vendburimet minerare, etj., ç'ka përbën një bazë të mjaftueshme për vlerësimin dhe krahasimin me veten dhe peshën që zënë në shkallë kombëtare.

Zbatimi dhe qasja ndaj Kapitalit Natyror ndihmon bashkinë Roskovec në realizimin e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, duke ju qasur ekosistemeve me pjesëmarrjen e tyre duke ofruar flukse të shërbimeve mbështetëse nga dimensionin e investimeve, nga dimensionin social, nga dimensionin rregullator dhe vendimmarrës për ekosistemin, dhe jo vetëm shfrytëzim dhe përfitim të pasurive.

Përpjekja për të vlerësuar në bashkinë Roskovec kapitalin natyror rezultoi në vlerat monetare në tabelën si vijon:

Tabela 26 Vlera e pasurisë natyrore të Bashkisë Roskovec

Lloji i kapitalit natyror	Nën-ndarja	Përdorimi	Fluksi monetar vjetor (lekë)	Aktivi monetar (lekë)
Burimet minerare			-	-
Burime ujore	Ujëra sipërfaqësore		65,788,240	1,194,575,937
	Ujëra nëntokësore		-	-
Pyjet dhe kullotat		lëndë drusore	-	-
		sekuestrimin/ absorbimin e karbonit	162,192,980	2,174,478,421
		për qira ¹⁶	60,455,271	366,263,215
		për qira ¹⁷	89,452,793	541,942,287
		për qira ¹⁸	358,417,874	2,178,867,775
Bujqësi dhe Blegtori	Toka bujqësore	Për qira	94,545,500	2,589,696,429
		prodhim bujqësor ara/ perime	13,169,990,000	-
		prodhim bujqësor fruta	709,218,360	-
	Blegtoria		3,563,940,000	52,762,537,915
Energjia	Energjia e rinovueshme	Fotovoltaike	9,281,540,736	98,658,276,141
		Biomasa	n/a	n/a
	Energjia jo-e rinovueshme	Naftë	28,711,823,213	101,957,270,945
Biodiversiteti		Flora	n/a	n/a
		Fauna	9,175,000	-
TOTAL			56,741,304,763	258,926,007,134

Tabela e mësipërme nuk përbën një vlerësim indikativ të aktiveve të rëndësishme siç janë flora dhe potenciali turistik i zonave të mbrojtura për shkak të mungesës të dhënave të detajuara për këto dy potenciale të mëdha të ardhurash vjetore.

¹⁶ Për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme

¹⁷ Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut

¹⁸ Për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike kampingje (kënde lodrash, mjedise sportive, shplohëse etj.)

5.2 REKOMANDIME

Praktikimi i zbatimit të metodologjisë së vlerësimit të kapitalit natyror në bashkinë Roskovec, na ndihmon të arrijmë në disa rekomandime për disa dimensione.

Dimensionet	Rekomandimet
Institucionale	<ol style="list-style-type: none"> 1. Bashkia duhet ta përfshijë këtë ushtrim si detyrë të rregullt periodike të zyrës së statistikave bashkiake. 2. Bashkia dhe institucionet qeveritare duhet të unifikojnë mënyrën e raportimit dhe të mbledhjes së të dhënave. 3. Sugjerohet që analiza gjithëpërfshirëse e KN në sasi dhe vlerë të bëhet pjesë e analizës së performancës së bashkisë dhe e Këshillit Bashkiak. 4. Sugjerohet hartimi i indikatorëve kyç të performancës për sa i përket KN, në nivel fluksesh vjetore dhe aktivesh, të cilët janë pjesë e analizës periodike të KN në nivel bashkiak dhe të Këshillit Bashkiak. 5. INSTAT duhet të unifikojë kërkesat për bashkitë për përgatitjen dhe mbajtjen e llogarive të kapitalit natyror duke përdorur Kuadrin e Llogarive Ekonomike Evropiane të Mjedisit (SKME-ve).
Administrative	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kuadër ligjor kombëtar për trajtimin e vlerësimit të kapitalit natyror. 2. Standardizim për vlerësimit dhe rishikimin e llogarive të kapitalit natyror vendor që ti përgjigjet kërkesave të INSTAT dhe Llogarive Ekonomike Evropiane të Mjedisit. 3. Vendime të Këshillit Bashkiak për të organizuar burime njerëzore dedikuar kapitalit natyror. 4. Mbajtjen e një regjistri të kapitalit natyror dhe llogarive përkatëse dhe rishikim tyre çdo 1-2 vjet. 5. Verifikimi në terren, nga ana e bashkisë, së gjendjes së kapitalit natyror në terren të paktën çdo 5 vjet ose duke ruajtur këtë frekuencë dhe duke verifikuar fizikisht lloje të ndryshme të KN.
Infrastrukturore	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për të trajtuar kapitalin natyror. 2. Paisje me mjete të teknologjisë së informacionit. 3. Programe softuerike që mundësojnë përpunimin dhe gjenerimin të dhënash.
Kulturore	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kultura organizative e bashkisë por dhe e institucioneve qeveritare duhet të ndryshojë duke u fokusuar në trajtimin e çështjeve të kapitalit natyror. 2. Angazhim qytetar në çështjet e mjedisit dhe ekosistemit për të ardhmen e qëndrueshme të mjedisit. 3. Mobilizimi i investimeve të sektorit publik dhe privat duke forcuar instrumentet fiskale dhe ekonomike që synojnë mbështetje të lartë për zinxhirët e furnizimit dhe mbrojtjes së mjedisit.

6. LITERATURË

- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (2021). Raportim mbi Hidrokarburet. Tirana, Albania.
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (2020). Prodhimi i Naftes dhe Gazit Shoqerues per vitin 2019. Tirana, Albania.
- Atelier 4, (2020). Vleresimi Strategjik Mjedisor, Plani i Pergjithshem Vendor, Bashkia Roskovec. Tirane, Albania.
- Banker Petroleum Albania (2011). BANKERS PETROLEUM ANNOUNCES 2010 RESERVES REPORT.
- Bashkia Roskovec, (a.d.). Të dhëna mbi Vendburimin Patos Marinëz.
- Bashkia Roskovec, Vendime të Keshillit Bashkiak për Buxhetin 2022
- Bashkia Roskovec, Raporti “Bashkia dhe burimet e zeza”
- Bashkia Roskovec, Profili i bashkisë, website <https://bashkiaroskovec.gov.al>
- Romated, Plani i veprimeve për perfshirjen sociale 19-22
- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (2015). Harta e Burimeve Minerare. Tiranë.

Shtojca A: foto nga Konsultimi i raportit kapitali natyror



